



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 007 prot.

Tiranë, më 01 . 08 . 2024

URDHËR

Nr. 174, datë 01.08.2024

“Për pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin C, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 13, germa “c”, nenin 14, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 7, pika 1 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve sipas nenit 24, pika 1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, për periudhën nga data 05.08.2024 deri më 09.09.2024¹, për çështjet e përfunduara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



¹ Data 09.09.2024 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.